

**PROCESVERBAL**  
**nga seanca e 28-të e Këshillit të Agjencisë për Shërbime**  
**Mediatike Audio dhe Audiovizuale**  
**mbajtur më 29.8.2023**

**Anëtarët e pranishëm të Këshillit të Agjencisë nëpërmjet lidhjes video-konferencë:** Lazo Petrushevski kryetar i Këshillit të ASHMA-së, Selver Ajdini zëvendës kryetar i Këshillit të ASHMA-së, mr. Alma Mashoviq, dr. Metodija Jançeski, Lllazar Trajçev, Zoran Fidanoski.

**Anëtarët në mungesë të Këshillit të Agjencisë: /**

**Në seancë nëpërmjet lidhjes video-konferencë ishte i pranishëm dhe dr. Zoran Trajçevski, drejtor i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale.**

**Të pranishëm nga Shërbimi profesional nëpërmjet lidhjes video-konferencë:** mr. Dragica Ljubevska, Cvetanka Mitrevska, Goran Radunoviq, mr. Magdalena Davidovska Dogleva, Shqipe Tahiri, mr. Ruzhica Boshnakoska Jotevska, dr.Ivana Stojanovska.

**Të pranishmit e tjerë : /**

Z. Petrushevski e hapi seancën e 28-të të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale. Seanca filloi në ora 14:10 dhe u mbajt nëpërmjet lidhjes video-konferencë.

Z. Fidanoski propozoi që Pika nr.2 - Propozim-vendim për heqjen e lejes për transmetim televiziv të SHTR TELEVISIONI POLOG SHPKNJP Tetovë, nr.08-354 datë 30.6.2016 të spostohet si pikë e parafundit, me qëllim për t'i dhënë kohë shtesë transmetuesit për pagesë, pra para përfundimit të seancës edhe një herë të bëhet verifikim nëse e ka kryer pagesën.

Z. Petrushevski u pajtua dhe vendimin e propozuar për heqjen e lejes e vendosi si Pikën nr.7

Këshilli i Agjencisë njëzëri, me 6 vota "pro" (votimi i znj. Mashoviq ishte nëpërmjet audio linkut) miratoi të korrigjuar:

**RENDIN E DITËS**

1. Miratimi i Propozim-procesverbalit nga seanca e 27-të e Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, mbajtur më 16.8.2023.
2. Propozim për shqiptimin e masës vërejtje publike të SHTR RADIO Pro-FM nga Gostivari për shkelje të nenit 15, paragrafi (3) të Ligjit për Media.
3. Propozim për shpallje të konkursi publik për themelimin e marrëdhënies së punës dhe zbatimin e procedurës për punësim në kohë të pacaktuar, me propozim-vendim dhe propozim-shpallje publike.

4. Propozim për dhënie miratim për zbatimin e procedurës për furnizim publik-shërbim: Hulumtimi i kompetencave të fëmijëve për arsimimin mediatik.
5. Propozim për shqiptimin e masës vërejtje publike të SHTR TV K&M KISS&MENADA SHPKNJP Tetovë për shkelje të nenit 14 të Ligjit për Media.
6. Propozim për shqiptimin e masës vërejtje publike të SHTR TV K&M KISS&MENADA SHPKNJP Tetovë për shkelje të nenit 51, paragrafi (1) të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele.
7. Propozim-vendim për heqjen e lejes për transmetim televiziv të SHTR TELEVISIONI POLOG SHPKNJP Tetovë, nr.08-354 datë 30.6.2016.
8. Të ndryshme.

### **Pika 1**

Këshilli i Agjencisë shqyrtoi dhe njëzëri (votimi i znj. Mashoviq ishte nëpërmjet audio linkut) miratoi Procesverbalin e propozuar nga seanca e 27-të e Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, mbajtur më 16.8.2023, me tekstin e propozuar.

### **Pika 2**

Udhëheqësja e Sektorit për Planifikim Strategjik dhe të Drejtat e Autorit mr. Magdalena Davidovska Dovleva, ka shpjeguar Propozimin për shqiptimin e masës vërejtje publike të SHTE RADIO Pro-FM nga Gostivari për shkelje të nenit 15, paragrafi (3) të Ligjit për Media. Ajo shpjegoi se ky transmetues në afatin e dytë të paraparë nuk ka publikuar në programin e tij të dhënat për strukturën e pronësisë, redaktorin përgjegjës/redaktorët dhe burimet e financimit në vitin paraprak (reklama, sponsorizimi, shitjet e përmbajtjeve, shërbimet e ofruara palëve të treta, etj.) dhe Agjencisë nuk i dorëzoi regjistrim të shpalljes në afat prej 15 ditësh nga dita e publikimit. Sipas ligjit, është kërkuar të deklarohet në lidhje me shkeljen e konstatuar, por ai nuk ka paraqitur deklaratë. Ajo tha se ka pasur bisedë telefonike me përfaqësues të medias në lidhje me shkeljen i cili ka njoftuar se në afatin shtesë do të përmbushë detyrimin ligjor. Për këtë arsye, propozohet që të shqiptohet masë vërejtje publike me afat respektimi prej 45 ditësh nga dita e pranimit të vendimit.

Këshilli i Agjencisë ka shqyrtuar Raportin me shkrim për mbikëqyrjen e kryer të rregullt administrative, nr.03-2934/1 të datës 24.7.2023 dhe njëzëri (votimi i znj. Mashoviq ishte nëpërmjet audio linkut) konkludoi që SHTR RADIO Pro-FM nga Gostivari t'i shqiptoi masë vërejtje publike për shkelje të nenit 15, paragrafi (3) të Ligjit për Media, sepse në afatin e dytë të paraparë nuk ka publikuar në program të dhënat për strukturën e pronësisë, redaktorin përgjegjës/ redaktorët dhe për burimet e financimit në vitin paraprak (reklama, sponsorizimi, shitjet e përmbajtjeve, shërbimet e ofruara palëve të treta, etj.) dhe Agjencisë nuk i dorëzoi regjistrim të shpalljes në afat prej 15 ditësh nga dita e publikimit.

Në përputhje me Udhëzimin për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrje të masës nr.01-4139/1 datë 7.11.2022, detyrohet që në afat prej 45 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit të harmonizoj veprimtarinë e tij me dispozitat e Ligjit për Media.

Sektori për çështje juridike dhe furnizime publike të përgatisë aktvendimin për shqiptimin e masës vërejtje publike transmetuesit në fjalë.

Sektori për planifikim strategjik dhe të drejtat e autorit pas skadimit të afatit të përcaktuar në Aktvendimin për vërejtje publike të kryejë mbikëqyrje kontrolli, për të përcaktuar nëse subjekti i mbikëqyrjes (transmetuesi) ka vepruar sipas masës së shqiptuar (plotësisht, pjesërisht ose nuk veproi).

Sektori për përkrahjen e punës së drejtorit dhe Këshillit vendimin e mësipërm ta publikojë në ueb faqen e Agjencisë.

### **Pika 3**

Z. Trajçevski shpjegoi Propozimin për shpalljen e konkursit publik për themelimin e marrëdhënies së punës dhe zbatimin e procedurës për punësim në kohë të pacaktuar. Ai ka shpjeguar se më 25 maj 2020, shoferi i punësuar në Agjenci ka dalë në pension dhe që atëherë më saktë, që nga data 3 tetor 2020, në mënyra të ndryshme është angazhuar person për të kryer këtë pozicion të punës, përmes Agjencisë për punësim të përkohshëm dhe nëpërmjet kontratës për punë me kohë të caktuar. Tashmë janë shteruar mundësitë ligjore për shfrytëzimin e mëturjeshëm të formave të tilla të punësimit (angazhimit) dhe për këtë arsye si formë e re propozohet shpallja e konkursit për punësim me kohë të pacaktuar.

Z. Trajçev pyeti nëse është e mundur të rritet numri i ditëve për aplikimin e dokumenteve nga personat e interesuar, pasi janë dhënë vetëm 5 ditë. Kjo do të rrisë konkurrencën dhe mundësinë për të aplikuar më shumë persona.

Z. Trajçevski sqaroi se për këtë vend punë nuk nevojiten dokumente të veçanta që dikush të aplikojë, ato janë dokumente standarde. Ai ka thënë se edhe në të kaluarën Agjencia ka respektuar këto afate. Ai ka sqaruar se kontrata aktuale e personit të angazhuar si shofer skadon më 3 tetor të këtij viti.

Z. Trajçev tha se nuk sheh arsye për kohëzgjatjen e shpalljes publike në mënyrë që të interesuarit të kenë më shumë mundësi për të konkurruar. Për të 5 ditë është afat i shkurtër.

Z. Trajçevski u pajtua dhe propozoi që shpallja publike të zgjasë 7 ditë, me faktin se pas seancës do të korrigojen të gjitha dokumentet dhe votimi aktual do të jetë që shpallja publike të zgjasë 7 (shtatë) ditë pune, duke llogaritur nga ditën e nesërme nga dita e publikimit.

Këshilli i Agjencisë njëzëri (votimi i znj. Mashoviq ishte nëpërmjet audio linkut) dha miratim që Drejtori i Agjencisë të marrë Vendim për shpalljen e konkursit publik për themelimin e marrëdhënies së punës dhe zbatimin e procedurës për punësim në Shërbimin Profesional të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale të 1 (një) përmbaruesi në vendin e punës: Shofer, dorëzues në Sektorin për punë të përgjithshme pranë Sektorit për mbështetje Informatike dhe punëve të përgjithëshme, në kohë të pacaktuar, me shpallje publike.

Shpallja publike do të zgjasë 7 (shtatë) ditë pune, duke llogaritur nga dita pas ditës së publikimit.

Sektori për përkrahje të punës së drejtorit dhe Këshillit, Shpalljen publike ta publikon në 2 (dy) gazeta ditore, përkatësisht: 1 (një) gazetë ditore në gjuhën maqedonase dhe 1 (një) gazetë ditore të botuar në gjuhën e bashkësisë joshumicë, por që e flasin së paku 20% e qytetarëve që flasin gjuhë zyrtare të ndryshme nga gjuha maqedonase, në ngarkesë të Agjencia për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale si punëdhënës.

#### **Pika 4**

Z. Trajçevski shpjegoi Propozimin për dhënien e miratimit për zbatimin e procedurës për furnizim publik: Hulumtimi i kompetencave të fëmijëve për arsimimin mediatik. Ai shpjegoi se Agjencia kryen hulumtime për arsimimin mediatik çdo vit me grupe të ndryshme.

Udhëheqësja e Sektorit për Çështje Juridike dhe Furnizime Publike, Cvetanka Mitrevska sqaroi se përveç asaj që është paraparë në Programin vjetor të punës së Agjencisë për vitin 2023, është paraparë edhe në Planin vjetor për furnizime publike për vitin 2023. Sipas shumës së parashikuar, furnizimi do të kryhet si furnizim (prokurim) me vlerë të vogël, njoftimi do të publikohet vetëm në sistemin elektronik të furnizimit publik. Ky lloj hulumtimi për këtë target grup po bëhet për herë të parë.

Z. Fidanoski deklaroi se do të mbështesë furnizimin publik, sepse sipas tij bëhet fjalë për hulumtim jashtëzakonisht të rëndësishëm. Ai u pajtua me z. Trajçevski se çdo vit Agjencia bën hulumtime për arsimimin mediatik, por për herë të parë si target grup janë fëmijët. Ai theksoi se do të ishte interesante të shiheshin rezultatet nga ky hulumtim sepse sipas tij bëhet fjalë për kategori moshe të rritur që teknologjikisht është shumë e avancuar në përdorimin e asaj që në gjuhën popullore (popullorisht) thuhet "gazheti", por se sa fëmijët kanë arsimim mediatik mbetet të shihet. Ai beson se ky hulumtim do të gjejë bazë të mirë dhe do të ndihmojë shumë në procesin e vënies (futjes) së arsimimit mediatik në procesin arsimor.

Z. Trajçev tha se ky është komponent shumë domethënës, veçanërisht në epokën e re të rritjes së informacioneve dhe teknologjive të reja. Ky hulumtim do të ofrojë parametra që mund të përdoren edhe më tutje. Ai tha si gjithmonë edhe tani se do të reagojë proceduralisht në pjesën e kriterëve për përcaktimin e ofertuesit më të favorshëm, pra nuk pajtohet me një raport të tillë cilësie dhe çmimi. Edhe pse tha se kjo nuk është përgjegjësi e Këshillit, ai dëshiron ta vërë në dukje.

Z. Petrushevski tha se këtë herë bëhet fjalë për raport 40% çmim dhe 60% cilësi.

Z. Fidanoski tha se ai dhe z. Trajçev kanë qëndrim të ngjashëm për rëndësinë e analizës. Në parim si gjithmonë edhe këtë herë do të thotë se për këtë lloj hulumtimi ky raport çmimi dhe kualiteti nuk është aspak problematik, sepse në fund të fundit duhet të merret një hulumtim cilësor.

Këshilli i Agjencisë njëzëri (votimi i znj. Mashoviq ishte nëpërmjet audio linkut) dha miratim për zbatimin e procedurës për furnizim publik-shërbim: Hulumtimi i kompetencave të fëmijëve për arsimim mediatik.

Zbatimi i procedurës së furnizimit publik për lëndën-shërbim: Hulumtimi i kompetencave të fëmijëve për arsimim mediatik është parashikuar dhe është në pajtim me Planin Vjetor për furnizim publik për vitin 2023 të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale nr.05-4766/1 të datës 23.12.2022, ndërsa mjetet janë siguruar nga Plani Financiar i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale për vitin 2023.

#### **Pikat 5 dhe 6**

Z. Petrushevski propozoi që Pikat 5 dhe 6 të sqarohen në një hyrje dhe diskutim të përbashkët, pasi bëhet fjalë për të njëjtin medium me shkelje të ndryshme të ligjit dhe votimi të bëhet për secilën pikë veç e veç.

Këshilli nuk kishte kundërshtim.

Udhëheqësja e Njesisë për mbikëqyrje programore dhe administrative Shqipe Tahiri ka shpjeguar Propozimin për shqiptimin e masës vërejtje publike të SHTR TV K&M KISS&MENADA SHPKNJP Tetovë për shkelje të nenit 14 të Ligjit për Media. Ajo ka shpjeguar se më 7 korrik të këtij viti është bërë mbikëqyrje e rregullt administrative në shërbimin programor televiziv të këtij transmetuesi. Me mbikëqyrjen është konstatuar se në disa pjesë të programeve nuk janë publikuar të dhëna që identifikojnë autorët që kanë marrë pjesë në përgatitjen e përmbajtjes programore. Sipas ligjit, transmetuesi është i obliguar t'i publikojë ato për çdo përmbajtje të transmetuar. Me këtë është bërë shkelje e nenit 14 të LM. Në të njëjtën ditë me mbikëqyrjen e rregullt administrative është konstatuar edhe shkelje e nenit 51, paragrafi (1) të LSHMAAV, gjegjësisht transmetuesi nuk ka ofruar informacionin që duhet t'u vihet në dispozicion shfrytëzuesve, siç është emri i plotë i ofruesit të shërbimit mediatik audiovizuel, adresën e selisë të ofruesit të shërbimit mediatik audiovizuel, të dhënat për kontakt (numri i telefonit, e-mail dhe/ose adresa e ueb faqes, personi përgjegjës për kontakt të shpejtë, të drejtpërdrejtë dhe efikas) dhe për organin rregullator kompetent. Ajo ka shpjeguar se nga media nuk është dorëzuar asnjë deklaratë dhe për këtë arsye propozohet që të shqiptohet masë vërejtje publike me afat prej 20 ditësh për respektimin e ligjit.

#### Votimi për pikën 5

Këshilli i Agjencisë shqyrtoi Raportin me shkrim për mbikëqyrjen e kryer të rregullt administrative, nr.10-3037/1 të datës 1.8.2023 dhe njëzëri (votimi i znj. Mashoviq ishte nëpërmjet audio linkut) konstatoi se SHTR TV K&M KISS&MENADA SHPKNJP Tetovë t'i shqiptoi masë vërejtje publike për shkelje të nenit 14 të Ligjit për Media, sepse më 7 korrik 2023 në disa pjesë të programeve të transmetuara nuk ka publikuar të dhëna për impresium që është i detyruar t'i transmetojë në vendin e përshtatshëm për çdo përmbajtje në veçanti të shërbimit programor.

Në përputhje me pikën 7 të Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrje të masës nr.01-4139/1 të datës 7.11.2022, është urdhëruar që në afat prej 20 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit të harmonizojë punën e tij me dispozitat e Ligjit për Media.

Spektori për Çështje Juridike dhe Furnizim Publik të hartojë Aktvendim për shqiptimin e masës vërejtje publike transmetuesit në fjalë.

Spektori për çështje programore pas skadimit të afatit të përcaktuar në Aktvendim për vërejtje publike të kryejë mbikëqyrje kontrolli, për të përcaktuar nëse subjekti i mbikëqyrjes (transmetuesi) ka vepruar sipas masës së shqiptuar (plotësisht, pjesërisht apo nuk ka vepruar).

Spektori për përkrahjen e punës së drejtorit dhe Këshillit, duhet ta publikojë aktvendimin e mësipërm në ueb faqen e Agjencisë.

#### Votimi për pikën 6

Këshilli i Agjencisë ka shqyrtuar Raportin me shkrim për mbikëqyrjen e kryer të rregullt administrative, nr.10-3036/1 të datës 1.8.2023 dhe njëzëri (votimi i znj. Mashoviq ishte nëpërmjet audio linkut) ka konstatuar se SHTR TV K&M KISS&MENADA SHPKNJP Tetovë

t'i shqiptojë masë vërejtje publike për shkelje të nenit 51, paragrafit (1) të LSHMAAV për shkak se më 7 korrik 2023, nuk ka ofruar informatat që duhet t'u vihen në dispozicion përdoruesve.

Në përputhje me pikën 6 të Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrje të masës nr.01-4139/1 datë 7.11.2022, është udhëzuar që në afat prej 20 ditësh nga dita e pranimi të aktvendimit të harmonizon punën e tij me dispozitat e Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale.

Sektori për Çështje Juridike dhe Furnizim Publik të hartojë Aktvendim për shqiptimin e masës vërejtje publike transmetuesit në fjalë.

Sektori për çështje programore pas skadimit të afatit të përcaktuar në Aktvendim për vërejtje publike të kryejë mbikëqyrje kontrolli, për të përcaktuar nëse subjekti i mbikëqyrjes (transmetuesi) ka vepruar sipas masës së shqiptuar (plotësisht, pjesërisht apo nuk ka vepruar).

Sektori për përkrahjen e punës së drejtorit dhe Këshillit, Aktvendimin e mësipërm ta publikojë në ueb faqen e Agjencisë.

## **Pika 7**

Z. Trajçevski në lidhje me Propozim-vendimin për heqjen e lejes për transmetim televiziv të SHTR TELEVISIONI POLOG SHPKNJP Tetovë, nr.08-354 datë 30.6.2016, sqaroi se disa herë gjatë seancës, gjithashtu edhe në këtë moment kryejn verifikim nëse ka pagesë, por transmetuesi ende nuk ka kryer pagesën e mjeteve. Transmetuesit i është thënë se nëse kryhen pagesë, të bëhet me njësi që të mund të shihen mjetet. Por deri në këtë moment, nga ora 14 deri në ora 20, nuk është bërë asnjë pagesë.

Z. Petrushevski sqaroi se pasi që Këshilli të marrë vendim dhe transmetuesi paguan nesër, ai do të duhet të kthejë lejen nëpërmjet gjykatës.

Z. Trajçevski sqaroi se këtij transmetuesi i është dhënë fatura për transmetim televiziv me 25% zbritje në pajtim me Vendimin e Këshillit që vlen për të gjithë transmetuesit. Në afatin e parashikuar nuk e ka paguar dëmshpërblimin. Më pas është ngritur procedurë për heqjen e lejes dhe i është dhënë afat shtesë prej 15 ditësh, i cili gjithashtu nuk është respektuar. Tani e vetmja mundësi ligjore është heqja e lejes. Ai informon se bëhet fjalë për 307.307,00 denarë.

Z. Ajdini tha se donte t'i bënte një pyetje drejtorit. Domethënë, në hyrje u tha se shërbimi ka kontaktuar me drejtorin e televizionit dhe pyeti se si kanë qenë indikacionet, nëse ka thënë se do të paguajë, a janë gati, sepse duken të pasigurt në deklaratat.

Z. Trajçevski tha se konkluzioni nga drejtori i televizionit është se ndoshta pronari do të ndryshojë mendje dhe do të paguajë. Duke vepruar kështu, ai është urdhëruar që deri në orën 14:00 të kryejë pagesën sipas njësive, sepse atëherë fillon seanca dhe që të mund Këshillit t'i prezantohet nëse pagesa është kryer apo jo. Ai po ashtu ka bërë të ditur se tani ka kryer verifikim por nuk është bërë pagesa, duke konfirmuar kështu se detyrimi ligjor nga ana e tij nuk është përmbushur. Ai shpjegoi se edhe dita e sotme është jashtë afatit të lejuar.

Këshilli i Agjencisë njëzëri (votimi i znj. Mashoviq ishte nëpërmjet audio linkut) miratoi Vendim për heqjen e lejes për transmetim televiziv të SHTR TELEVISIONI POLOG SHPKNJP Tetovë, nr.08-354, datë 30.6.2016, për shkak të mospagesës së kompensimit vjetor për lejen e transmetimit televiziv në afatin e përcaktuar me Ligj prej - 30 ditësh nga dita e pranimi të Faturës nr.2023-100-0169 datë 26.6.2023 (Nr ynë.ark.05-2620/1 datë 26.6.2023).

Sektor i për Çështje Juridike dhe Furnizim Publik të njoftojë ORRPKE-në, me të cilën transmetuesi ka lidhur kontratë, se Këshilli i Agjencisë miratoi Vendim për heqjen e lejes për transmetim televiziv të SHTR TELEVISIONI POLOG SHPKNJP Tetovë.

Sektor i për përkrahje të punës së drejtorit dhe Këshillit, vendimin e mësipërm ta publikon në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut", në ueb faqen e Agjencisë dhe në dy gazeta ditore, prej të cilave njëra është në gjuhën e bashkësisë joshumicë, por që e flasin së paku 20% e qytetarëve në Republikës së Maqedonisë së Veriut.

**Pika 8**

**Të ndryshme**

Nuk ka diskutim nën Të ndryshme.

**Nr. 02-3274/8**

**06.09.2023**

**Shkup**

**Agjencia për Shërbime Mediatike**

**Audio dhe Audiovizuale**

**Kryetari i Këshillit,**

**Lazo PETRUSHEVSKI, d.v.**